



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL.Anr. 809/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Valdete Prebreza, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Valdete Prebreza, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.809/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.809/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesja e apelit Valdete Prebreza, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, e cila pretendon se i mungojnë votat në këto qendra votimi: QV Shkolla Filllore “Zenel Hajdini” 1920e, Shkolla Filllore “Nazim Gafurri” QV 1920x dhe 1921x, Shkolla Filllore “Nënë Tereza” 1956e, Shkolla Filllore “Anton Zako Çajupi” 1931e, Shkolla Filllore “1901e dhe 1914e, Fakulteti Ekonomik 1913e, Shkolla Filllore “Meto Bajraktari” 1924e, Shkolla Filllore “Shkëndija” 1927e, Salla e sporteve ” 1 tetori” 1912e.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelueses gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk është specifikuar saktë dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet e lartcekura. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si i tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL.Anr.809/2017 më datën 12.11.2017.



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*